

DITARI MUJOR QERSHOR 2025

PËRFUNDOJNË NDËRHYRJET RESTAURUESE DHE KONSERVUESE NË XHAMINË E ALLAJBEGISË, DIBËR!

Falë mbështetjes së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me një projekt të hartuar nga IKTK dhe të ndjekur nga DRTK Tiranë, kjo pasuri unike kulturore i kthehet komunitetit si një monument i restauruar me dinjitet, duke ruajtur vlerat arkitekturore dhe historike që e karakterizojnë.

Një tjetër hap domethënës në mbrojtje të trashëgimisë sonë të përbashkët.



SONDAZHE ARKEOLOGJIKE NË KODRËN E SHËN GJERGJIT – BISHTÇUKAS, DIVJAKË

Në kuadër të **Paktit me Universitetin**, arkeologët e IKTK-së, në bashkëpunim me **FHF**, **Muzeun Historik të Lushnjës** dhe me mbështetjen e **Bashkisë Divjakë**, po realizojnë për herë të parë një operacion të plotë arkeologjik në këtë sit me status Monument Kulture.

Gërmimet kanë zbuluar struktura dhe objekte të periudhave të ndryshme historike – nga antikiteti i vonë, mesjeta deri në shek. XIX – duke përfshirë tjegulla, enë qeramike, monedha dhe tulla me monograme.

Procesi vijon për të kuptuar më thellë historinë dhe shtrirjen e këtij vendbanimi të lashtë.





INSPEKTIME NË TERREN

Specialistët e IKTK, në përmbushje të misionit të tyre për gjurmimin dhe hulumtimin e trashëgimisë kulturore, kanë vijuar vizitat në terren në qytetin e **Konispolit**, në funksion të evidentimit të vlerave kulturore që ky qytet mbart.

Fokusi i kësaj vizite ishte:

- zhvillimi urban,
- objektet përfaqësuese të arkitekturës vernakolare,
- si dhe teknikat tradicionale ndërtimore të ruajtura ndër vite.

Materialet e grumbulluara do të shërbejnë për studime të mëtejshme me synim propozimin e deklarimit të interesit kulturor të qytetit të Konispolit.



PLANI I MENAXHIMIT BYLIS-KLOS

Në vijim të **Planit të Menaxhimit për Bylisin dhe Klosin**, dhe në përmbushje të misionit të saj, IKTK ka nisur punën në terren për zonifikimin arkeologjik të këtyre dy siteve të rëndësishme.

Qëllimi i këtij procesi është krijimi i një zonifikimi me kufij të qartë dhe koordinata gjeografike, në përputhje me standardet bashkëkohore të përcaktuara nga ASIG.

Punimet po zhvillohen në bashkëpunim me **NJAKPA Apoloni-Bylis** dhe **AICS**.



PARIS, UNESCO | 16–19 QERSHOR 2025

IKTK mori pjesë në konferencën e organizuar nga **UNESCO** në kuadër të Sesionit të 10-të të Shteteve Palë të Konventës së 2001 për **Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore** dhe **Takimit të 16-të të Grupit Këshillimor Shkencor dhe Teknik (STAB)**.

Fokusi i diskutimeve ishte arkeologjia nënujore dhe sfidat që sjellin ndryshimet klimatike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore. Këto takime përforcojnë përpjekjet e **Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit** dhe IKTK për ngritjen e infrastrukturës institucionale dhe teknike në mbrojtje të pasurive nënujore shqiptare.



TRAJNIM NDËRKOMBËTAR PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË RASTE FATKEQËSISH

Përfaqësues të IKTK morën pjesë në trajnimin **“Mbrotjtja e Trashëgimisë Kulturore nga Pasojat e Fatkeqësive” | 16-20 Qershor 2025**, zhvilluar në kuadër të projektit **ProCultHer-Net 2 të DG-Echo**.

Trajnimi ofroi një përvojë të vlefshme si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, duke trajtuar ndërhyrjet e menjëhershme për mbrojtjen e pasurive kulturore në raste emergjente dhe procesin e rikuperimit të tyre pas fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njeriu.

